



## Kërkesë për punësim Pedagog me gradën Doktor i Shkencave në fushën e Arkitekturës

SHLUJ "Universiteti Marin Barleti", në kuadër të procesit të plotësimit të personelit akademik të Departamentit të Arkitekturës dhe Dizajnit kërkojmë të punësojmë personal akademik efektiv dhe eksperiencë në projekte.

Kandidati të ketë si përgjegjesi zbatimin e të gjitha detyrimeve që përcaktohen në ligjin nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe zbatimin e detyrimeve që përcaktohen në statutin dhe rregulloret e SHLUJ "Universitetit Marin Barleti" për pozicionin që do të mbulojë.

Kandidati duhet të përmbushë këto kritere:

- Të jetë i diplomuar (preferohet në një nga vëndet e BE-së) në fushën e Arkitekturës.
- Të ketë së paku gradën shkencore "Doktor"
- Të ketë përvojë në mësimdhënie në fushën e Arkitekturës.
- Të paktën 2 vite eksperiencë profesionale në fushën e menaxhimit, koordinimit dhe raportimit të projekteve të financuara nga BE ose donatorë të tjerë;
- Të ketë përvojë në kërkimin shkencor;
- Të ketë aftësi shumë të mira koordinuese, organizative dhe komunikuese për të punuar në një projekt me shumë partnerë ndërkombëtarë dhe për të lehtësuar bashkëpunimin midis palëve;
- Njohje shumë të mirë të gjuhës angleze dhe italiane;
- Njohuri shumë të mira kompjuterike (Paketa Office etj).

### Procedura e aplikimit:

Kandidatët aplikues, **deri në datën 15 shkurt 2020**, duhet të dorëzojnë pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore në "Universiteti Marin Barleti" (në formë të printuar) si dhe në adresën elektronike [hr@umb.edu.al](mailto:hr@umb.edu.al), dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kopje të noterizuar të diplomave dhe listës së notave të studimeve universitare dhe pasuniversitare;
- Një CV të përditësuar, në gjuhën shqipe dhe angleze, në formatin Europass;
- Një letër interesi për pozicionin për të cilin aplikon;
- Dy kontakte reference. (opcionale)

Vetëm personat që plotësojnë kriteret e vendosura më sipër do të kontaktohen.

Të dhënat e aplikantëve mblidhen, përpunohen dhe trajtohen në mënyrë konfidenciale në përputhje me Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".